

SHOQËRIA ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Ameral Investment Group" SHPK, me seli në Tiranë, ALBANIA

NUIS: M42001024C

V E N D I M
I ASAMBLESË SË PËRGGJITHSHME

Sot, e hënë, në datën 26/08/2024 ora 13:00, në selinë e shoqërisë, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë "Ameral Investment Group" shpk, me pjesëmarrje të:

- Ortakut **Redian Kolaneci** zotërues i një kuote që përfaqëson 51% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ameral Investment Group" sh.p.k.
- Ortakut **Vasil Olgert Petriti** zotërues i një kuote që përfaqëson 49% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Ameral Investment Group" sh.p.k.

Drejtuasi i mbledhjes është administratori i shoqërisë **Redian Kolaneci**, i cili pasi verifikoi thirrjen e rregullt dhe pjesëmarrjen e ortakëve në këtë mbledhje, konfirmoi se kjo mbledhje mund të zhvillohet pasi plotësohet shumica e domosdoshme që kërkon ligji nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe statuti i shoqërisë.

Mbledhja mori në shqyrtim rendin e paracaktuar:

1. Shtimin e kapitalit të shoqërisë.
2. Të ndryshme dhe të mundshme.

Lidhur me çështjen e parë të caktuar për t'u diskutuar në rendin e ditës, administratori parashtrioi:

Shoqëria në kushtet të cilat ndodhet ka të nevojshme shtimin e kapitalit të shoqërisë për shkak se shoqëria ka një plan investimi për zhvillimin dhe ecurinë e saj, shpenzimet e të cilit nuk mund të mbulohen nga kapitali aktual i shoqërisë. Vlera në të cilën kërkohet finacimi është në vlerën 100000 (Njëqind mijë) dollar e perkthyer ne vlerën lekë 8960000 (tetë milion e nëntë qind e gjashtëdhjet mijë) lekë , kontribut ky në para ose në natyrë lidhur me shërbimet operationale të shoqërisë.

Ortaku **Vasil Olgert Petriti** mori fjalën dhe tha: Unë do të kontribuoj për shtimin e kapitalit në vlerën 49000 (dyzet e nëntë mijë) dollar e perkthyer ne vlerën lekë 4390400 (katër milion e treqind e nentëdhjetë mijë e katër qind) lekë që do të jenë kontribut në para.

Ortaku **Redian Kolaneci** mori fjalën dhe tha: Unë për shtimin e kapitalit do të kontribuoj në natyrë me anë të shërbimit lidhur me rritjen dhe zgjerimin e kompanisë, zhvillimin e idesë koncept të nisjes së këtij biznesi dhe gjithçka lidhur me rritjen dhe përmirësimin e proceseve të punë, konsulencës bussines to bussines, shërbimit të marketingut, logjistikës, për një afat të pacaktuar e perkthyer në vlerë monetare në vlerën 51000 (pesëdhjet e një mijë) dollar e perkthyer ne vlerën lekë 4569600 (katër milion e pesëqind e gjashtëdhjet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë .

Në fund të mbledhjes, duke mos pasur asgjë tjetër për të diskutuar, ortakët i kërkuan drejtuesit të mbledhjes të kalojnë në votim për çdo pikë të rendit të ditës. Në fund, Asambleja e Përgjithshme:

VENDOSI

1. Të miratojë shtimin e kapitalit të shoqërisë në vlerën totale prej 100000 (njëqind mijë) dollar e perkthyer ne vlerën lekë 8960000 (tetë milion e nëntë qind e gjashtëdhjet mijë) lekë prej të cilat, 49000 (dyzet e nëntë mijë) dollar, e perkthyer ne vlerën lekë 4390400 (katër milion e treqind e nentëdhjetë mijë e katër qind) lekë që do të jenë kontribut në para nga ortaku **Vasil Olgert Petruti** dhe 51000 (pesëdhjetë e një mijë) dollar, e perkthyer ne vlerën lekë 4569600 (katër milion e pesëqind e gjashtëdhjet e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë që do të jenë kontribut në natyrë nga ortaku **Redian Kolaneci**.
2. Të bëhet depozitimi i këtij vendimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
3. Vendimi përpilohet në 3 (tre) kopje.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme u mbyll nga drejtuesi i saj në datën 26/08/2024 ora 14:00

ORTAKËT

Z. Vasil Olgert Petruti

VASIL PETRUTI
Vasil Petruti
8/26/24

Ameral Investment Group
Sh.p.k.
NUIS: M42001024C
TIRANE - ALBANIA

Z. Redian Kolaneci

Redian Kolaneci

